

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj, meqenëse po flasim për tregun financiar, disa konstatime, të cilat besoj se janë shumë të rëndësishme se ku jemi dhe çfarë po ndodh në Shqipëri MONEYVAL-i, organi monitorues i Këshillit të Europës për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, e vendosi Shqipërinë për të dytin vit radhazi midis vendeve në zonën gri për pastrimin e parave. Fondi Monetar Ndërkombëtar ka ngritur dyshime për pastrim të parave në tregun e pasurive të paluajtshme dhe i kërkon qeverisë shqiptare të monitorojë lejet e ndërtimit. Indeksi i Bazelit, në renditjen e pavarur vjetore për vlerësimet që vijnë nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, e rendit Shqipërinë nga 110 vende, në vendin e 72-të. Shqipëria u vendos sërish në listën gri për pastrimin e parave.

Të nderuar kolegë,

E gjithë bota është përballë një krize jashtëzakonisht të rëndë ekonomike. Putini, me pushtimin e paligjshëm të Ukrainës, ka krijuar një konfuzion dhe pengesa reale për interesat e tij gjeopolitike, e mbështetur edhe nga fuqi të tjera, siç është Kina. Qartësisht, sot bota është nën kërcënimin e pasigurisë ushqimore dhe të asaj energjetike, por edhe e lëndëve të para. Rënia ekonomike në Shqipëri do të jetë shumë e ndjeshme. Inflacioni është në rritje në vendet e rajonit dhe më gjerë. Kjo do të ketë një ndikim jo të vogël në ekonominë shqiptare; çmimet e ushqimeve rriten progresivisht, sado të përpiqemi t'i mohojmë ato dhe e shoqëruar kjo me rritjen e inflacionit, bëhet akoma edhe më problematike. Rritja e çmimeve të naftës dhe të gazit ka ndikuar dhe do të ndikojë edhe në çmimet e të gjitha burimeve dhe të produkteve të tjera.

E gjithë kjo situatë e rëndë në vend shoqërohet me mungesën e konkurrencës së lirë, me tensionin e vazhdueshëm politik, korrupsionin, mundësinë për ringjalljen e konflikteve të vjetra apo të nxitura në rajonin tonë, me politikat fiskale, të cilat janë të disfavorshme, në gjykimin

tim, në raport me bizneset dhe investimet e huaja. Çmimet e larta të energjisë dhe të ushqimeve tregojnë qartë për një tablo të zymtë, e cila nuk mund të përballohet vetëm me diskutime apo me debate të pavlefshme në parlament. Në gjykimin tim, së pari, ka nevojë për mbështetje të biznesit, sidomos për një vlerësim të ngarkesës fiskale të taksave mbi biznesin. Së dyti, kemi taksat më të larta në rajon dhe pasiguria juridike e bën Shqipërinë një vend ku investimet e huaja direkte pësojnë rënie, nuk janë në nivelin që duhet.

Besoj se investimet e bëra nga Exxon Mobile, Exalerate Energy e të tjera do të kenë një ndikim pozitiv në investimet e huaja dhe në mënyrë të veçantë në interesin tonë për të pasur investime amerikane në sektorin energjetik. Duke vlerësuar edhe qëllimin e administratës amerikane për të garantuar furnizimin me gaz të Europës dhe shkëputjen nga varësia ruse, mendoj se ky është një oportunitet strategjik, për të cilin duhet të biem dakord të gjithë së bashku të gjejmë rrugët më të mira për të arritur të kemi sa më tepër investime të këtij lloji.

Dua të vlerësoj dhe të jap mbështetjen time për çdo marrëveshje të Shqipërisë për investime në fushën e energjisë me kompani amerikane. Kjo jo vetëm garanton një Shqipëri më të pavarur energjetikisht, por me një peshë shumë herë më të madhe në rajon. Së treti, nevoja për subvencione financiare për bizneset në vështirësi gjatë pandemisë, siç bënë shumë vende të rajonit, përfshirë edhe Kosovën, bëhet edhe më imediate përballë kësaj sate. Europa dhe rajoni po marrin masa për ta përballuar krizën e luftës. Ata përgjysmojnë taksat dhe bëjnë subvencione të drejta ndaj sipërmarrjeve private. Ndërsa në Shqipëri po ndodh e kundërta. Mjafton të përmend taksën 6 lekë për litër për gazin, që hyn në fuqi më 1 korrik dhe tentativën për të ndërhyrë në xhepat e shqiptarëve në tatimin mbi të ardhurat.

Kriza ushqimore do të ndikojë edhe në produktet shportës. Alternativa më e mirë është zerimi i TVSH-së për produktet e shportës, siç ka bërë Maqedonia e Veriut. TVSH-ja e inuteve bujqësore, nga 10%, të bëhet zero, siç ishte para 1 janarit të vitit 2022. Taksat i kemi më të larta, krahasuar me rajonin, në raport me Serbinë, edhe në raport me Maqedoninë e Veriut, edhe në raport me Kosovën, të cilat do të nxisin vetëm kontrabandën.

Të nderuar kolegë deputetë,

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg, deklaroi në Dallas: “Shumë prej nesh këtu sot kemi punuar për të promovuar një ekonomi më të globalizuar, por ne duhet të pranojmë se zgjedhjet tona ekonomike kanë pasojë për sigurinë tonë. Liria është më e rëndësishme sesa tregtia e lirë. Mbrojtja e vlerave tona është më e rëndësishme sesa fitimi. Konflikti në Ukrainë ka nënvizuar rëndësinë që Amerika e Veriut dhe Europa të jenë gjithmonë së bashku”. Këto mesazhe besoj se duhet t’i lexojmë qartë ne, si shqiptarë, jashtë debateve të pafrytshme dhe klisheve politike.

Nëse për 30 vjet kemi besuar te dialogu, nuk ka dyshim sot se deterrenca është rruga e zgjidhjes së problemeve. Mendoj se si vend i NATO-s dhe shpresoj si vend i ardhshëm i BE-së, me një peshë jo të madhe në ekonomi apo në ushtri, në rajon dhe në Europë, veprimet tona duhet të kenë bazë vlerësimin dhe qëndrimin e interesit tonë kombëtar dhe sigurinë kombëtare. Çdo nismë rajonale, ballkanike dhe më gjerë tejkalon thjesht dëshirat dhe qëndrimet e një qeverie apo vullnetin e liderëve të tyre. Sot më shumë se kurrë ka nevojë për vlerësim historik, marrëdhënie gjeopolitike dhe vlerësim të pasojave apo të përfitimeve në planin afatgjatë.

Nëse Amerika dhe Bashkimi Europian kërcënohen nga luftërat dhe tensionet e pamenduara më parë nga Rusia, nëse nismat që dukeshin si oportunitet ekonomik dikur, siç ishte 17 apo 16+1 me Kinën, Rruga e Mëndafshit apo penetrimi i Kinës nëpërmjet softpower-ve edhe në Amerikë, edhe në Europë, sot është një shqetësim real për aleatët dhe partnerët tanë, për më tepër duhet të jetë edhe për ne. Është koha të hapim edhe sytë, edhe mendjen. Ne nuk jemi të imunizuar nga provokimet dhe interesat e Ruisë apo qëllimet e Kinës, madje është e kundërta. Ne duhet të flasim për pasojat e pushtimit të Ukrainës nga Rusia; efektet që ka në Ballkan. Ne duhet të flasim dhe duhet të shohim se çfarë po ndodh në Serbi, në Bosnjë-Hercegovinë, në Kosovë dhe në Malin e Zi.

Ne në angazhimet tona rajonale, ekonomike dhe politike duhet të vlerësojmë se çdo nismë duhet detyrimisht të frenojë mundësinë e aksesit dhe të penetrimit politik, ekonomik, energjetik, të inteligjencës apo edhe ushtarake të Ruisë dhe të Kinës në rajon. Përndryshe, ne kemi vënë në diskutim interesin tonë kombëtar si shqiptarë, sigurinë tonë kombëtare, si dhe

liritë dhe të drejtat e qytetarëve shqiptarë. Vizitat e Lavrovit apo shefit të Inteligjencës ruse në Serbi nuk janë spontane. Putini përpiket të vendosë paralele ndërmjet Ukrainës dhe Kosovës, dhe kjo nuk është rastësi. Narrativa e Serbisë dhe Rusisë është e njëjtë dhe nuk ka deklarata të pastudiuara nga Moska dhe Beogradi, ato janë të mirëkoordinuara dhe përcaktojnë synime e qëllime për të krijuar tensione dhe kontroll në Ballkan. As shkëputja nga Bosnjë-Hercegovina e Republikës Sërpska nuk është një dëshirë e Dodikut, por një politikë e vendosur dhe e koordinuar ndërmjet Beogradit dhe Moskës.

Më thoni, kolegë deputetë, përse Serbia shpenzon sot 3% të PBB-së për armatim dhe mjete ushtarake, duke i blerë nga Rusia dhe Kina? Çfarë dhe kush e kërcënon sot Serbinë? Pse frenohet dialogu Serbi-Kosovë? Pse Vuçiç deklaroi me forcë se do të mbrojtë integritetin e Serbisë, përfshirë Kosovën dhe Metohinë? Pse Vuçiç i dërgon trupat e blinduar dhe avionët luftarakë në kufi me Kosovën, në unison me Rusinë dhe e mbështetur nga Kina? Në kohën kur BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë vendosur sanksione ndaj Rusisë dhe dënojnë krimet në Ukrainë, përse Serbia bën të kundërtën, po ashtu, si Kina? Nëse SHBA dhe BE kërkojnë shkëputjen e furnizimit me energji nga Rusia, pse Serbia bën të kundërtën dhe, po ashtu, kompanitë kineze kanë kthyer sanksionet dhe janë sot dominante në tregun rus?

Të nderuar kolegë,

Duke vlerësuar çdo mundësi të bashkëpunimit rajonal, dua të theksoj se ky bashkëpunim do të ketë vlerë nëse do të përfshihet në marrëdhënie, do të monitorohet dhe do të drejtohet nga BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, madje absolutisht në kuadër qoftë të Procesit të Berlinit, qoftë nismave më të mëdha dhe më të gjera, siç është ajo e Tre Deteve. Ka ardhur koha që ne këtu në parlament, por edhe si shqiptarë, të vendosim disa vija të kuqe. Të kuptojmë se interesi ynë kombëtar, bashkëpunimi i shqiptarëve si një komb kërkon të kemi qëndrime të përbashkëta dhe më pak protagonizëm, sidomos në çështje që na nxjerrin përpara botës si njerëz të vegjël dhe të papërgjegjshëm. Asnjë e ardhme nuk mund të ndërtohet mbi harresën. Kujtoj thënien e presidentit Clinton: “Askush nuk kërkon të harroni, por kërkon që ju të falni”, kjo ishte fjala e tij në Prishtinë pas luftës. Faljen nuk e ofron askush nga ne, nuk kemi të drejtë, por populli i Kosovës po. Ndërsa ndjesën dhe pendesën duhet ta bëjë Serbia.

Pra, duhet patjetër që Serbia të njohë krimet që ka bërë jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë ish-Jugosllavinë. Bota sot nuk është në paqe, as ne nuk jemi dhe për këtë arsye do të jemi më shumë se naivë nëse nuk shohim përtej qëndrimeve tona imediate apo deklaratave politike. Ne nuk mund të jemi pak kërkues karshi Serbisë, si SHBA-ja, BE-ja dhe Gjermania. Së bashku me zonjën Gjylameti ishim në një diskutim në një forum sigurie në Berlin. Të gjithë përfaqësuesit e partive politike njëzëri, në Bundestag, në mënyrë të veçantë Renata Alt, përfaqësuese e FDP-së, kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, jo vetëm kërkoi ngrirjen e negociatave të Serbisë me Bashkimin Europian, por deklaroi se Serbia nuk mund të bëjë lojë ndërmjet BE-së dhe Rusisë.

Është urgjente, sado problematike, që ne duhet të bisedojmë me Prishtinën. Marrëdhëniet e Tiranës me Prishtinën sot janë shumë të rëndësishme dhe kanë nevojë për një mirëkuptim. Si drejtues të Këshillit të Sigurisë së OKBsë sot kemi një përgjegjësi akoma edhe më të madhe. Përpara samitit të NATO-s, mendoj se do të jetë i vlefshëm një konsultim me vendet e tjera të NATO-s në Ballkan për të diskutuar çështjet e sigurisë dhe problematikën e rajonit të Ballkanit. Siguria nuk është chea, nuk është për shitje, të nderuar kolegë deputetë!